



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 11/9 Prot

Vlorë, më 15.07 .2022.

VENDIM

Nr.7, datë 06.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE, ME OSE PA UJË , ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT DUKAT, ZONA ORIKUM-DUKAT, QARKU VLORË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: Shtrati i Lumi Shushicë, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, për zbatimin e projektit “Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës VIA-Autostrada Fier Vlorë” me subjekt kontraktues “Fusha & 5D Konstruktion”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
Emri burimit ujor: Lumi Shushicës
Koordinatat e konturit të sheshit për shfrytëzim (KRGJSH):

Nr.	X	Y	Z
1	462857.80	4492076.50	14.15
2	462928.20	4492035.30	14.80
3	462895.80	4491912.10	13.57

4	462863.40	4491789.00	11.86
5	462820.60	4491626.40	14.36
6	462885.50	4491456.60	13.90
7	462685.30	4491539.70	11.96
8	462732.50	4491653.80	12.42
9	462796.80	4491809.30	13.79
10	462784.50	4491967.30	13.67

3. Sipërfaqja e taracës lumore që do të shfrytëzohet : 59 496 m² ;

4. Volumi i materialit të kërkuar : 30 000 m³ ;

5. Subjekti të respektojë të gjitha sygjerimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;

6. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU-Vjosë për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;

7. Të ndiqet nga ZABU- Vjosë zbatimi i projektit të rehabilitimit;

8. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;

9. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI
FLAMUR MAMAJ

